

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 19, datë 31.8.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 17, DATË 16.8.2021, “PËR VITIN SHKOLLOR 2021–2022 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

1. Në udhëzimin e përbashkët nr. 17, datë 16.8.2021, “Për vitin shkollor 2021–2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Pika 3, e kreut I/I.2, ndryshon si më poshtë:

“3. Zbatimin e udhëzuesve të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për arsimin fillor dhe arsimin e mesëm të ulët për përsëritjen e temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi, për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 1–24 shtator 2021.”.

b) Pika 2, e kreut I/I.3.1, ndryshon si më poshtë:

“2. Vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë të stafit me prindërit dhe komunitetin, për krijimin e një modeli të ri të sjelljes së nxënësve, mësuesve dhe prindërve në ambientet e shkollës dhe jashtë saj, bazuar në protokollet e situatës së COVID-19. Zbatimin e udhëzuesit të ASCAP-it për arsimin e mesëm të lartë për përsëritjen e temave mësimore për të cilat janë evidentuar mangësi, për shkak të zhvillimit të mësimin në kushtet e pandemisë. Ky proces do të realizohet gjatë periudhës 1–24 shtator 2021.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Evis Kushi

MINISTËR I FINANCVE DHE EKONOMISË

Anila Denaj